



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 743/16 Prot

Tiranë, më 2/10/2013

REKOMANDIM

Nr. 27 datë 02/10 /2013

Mbështetur në ligj nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 "*Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "*Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "*Qendra Shëndetësore, Peshkopi*".

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr. 125 datë 03.07.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit "*Qendra Shëndetësore, Peshkopi*" me adresë, "*Lagja Dobrov*", Peshkopi. Ky kontroll administrativ u fillua kryesisht nga Komisioneri.

Objekti i Kontrollit administrativ ishte:

- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë Autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (neni 21).
- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi Qendra Shëndetësore Peshkopi, për kategorinë e subjekteve të të dhënave "Pacient".
- Masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale të pacientëve (neni 27).

Grupi i kontrollit administrativ:

- Intervistoi dhe mori deklarime nga përfaqësuesja e kontrolluesit.
- Inspektoi ambientet e punës të këtij kontrolluesi.

Gjatë kontrollit administrativ përfaqësuesit e kontrolluesit u treguan bashkëpunues dhe vendosën në dispozicion të grupit të kontrollit të gjitha materialet dhe dokumentat e kërkuara.

Kontrolluesi “Qendra Shëndetësore, Peshkopi” kryen aktivitetin e tij në fushën e kujdesit shëndetësor parësor dhe gjatë këtij aktiviteti mbledh dhe përpunon të dhëna personale/sensitive për kategorinë pacientë dhe punonjës.

Për kategorinë “pacient” gjatë aktivitetit të tij kontrolluesi mbledh të dhëna personale dhe sensitive si; *emri, atësia, mbiemri, data e lindjes, gjinia, mosha, numri i telefonit, adresa, arsimi, profesioni, qendra e punës, gjendja civile, numri i kartelës personale/librezës shëndetësore/siguracionit shëndetësor dhe i pasaportës ose certifikatës, gjeneralitetet e bashkëshortit (për kartelat e grave shtatzëna), emri i personit që e ka në ngarkim pacientin (fakultative), anamneza e jetës, ekzaminime dhe analiza, diagnoza, grupi i gjakut/rezusi, gjatësia dhe pesha e fëmijës, trajtimi me medikamente, të dhëna mbi alergjitë dhe reaksionet e mundshme.* Këto të dhëna mblidhen nga mjekët, në mënyrë manuale, nëpërmjet plotësimit të “Kartelës personale të pacientit”, “Kartelës individuale për të rritur dhe fëmijë”, “Kartelës së konsultorit të ndjekjes së gruas shtatzënë” dhe “Regjistrin themeltar të mjekut të familjes”, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe ISKSH, në kuadër të zbatimit të detyrimeve ligjore.

Gjithashtu personeli i mjekëve mbledh dhe përpunon të dhëna personale përmes plotësimit të ‘regjistrin elektronik të pacientëve’ i cili administrohet nga ISKSH (me adresë www.isksh.com.al). Në këtë regjister hidhen të dhëna personale si; *emri, atësia, mbiemri, data e lindjes, vendndodhja, numri i identifikimit të personit, dhe statusi (aktiv apo jo).*

Për kategorinë “punonjës” kontrolluesi mbledh të dhëna personale si; *emri, atësia, mbiemri, data e lindjes, vendlindja, numrin e librezës së punës, gjendja shoqërore, arsimi, vendi/lloji i punës, paga, kualifikime.* Këto të dhëna administrohen në “Dosjen personale të punonjësit” dhe në “Regjistrin themeltar të punonjësve”, bazuar në legjislacionin e punës.

Të dhënat personale të pacientëve dhe punonjësve nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin për të cilat ato mblidhen dhe përpunohen. Qëllimi i mbledhjes dhe i përpunimit të të dhënave personale për pacientët është vetëm ofrimi i shërbimeve në fushën e shëndetësisë. Ndërsa qëllimi i mbledhjes dhe i përpunimit të të dhënave personale për punonjësit lidhet me mbarëvajtjen e punës në kuadër të zbatimit të legjislacionit përkatës në këtë fushë.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se, meqenëse kontrolluesi “Qendra Shëndetësore, Peshkopi”, gjatë veprimtarisë mbledh dhe përpunon të dhëna sensitive, për të cilat nuk ka njoftuar (në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar), atëherë lind nevoja e përditësimit të njofimit të kryer më parë.

Sa i përket respektimit të parimit të mjaftueshmërisë dhe proporcionalitetit në përpunimin e të dhënave personale/sensitive të pacientëve, Komisioneri vlerëson se kontrolluesi vepron në përputhje me to dhe nuk ka tejkallim të qëllimit të përpunimit apo të dhëna që të konsiderohen të tepërta (përpunimi i tyre është detyrim ligjor).

Komisioneri vlerëson se në kuadër të zbatimit të nenit 6 të ligjit, kontrolluesi i përpunon të dhënat personale në zbatim të plotë të pikës 1 të nenit 6 por me përjashtim të shkronjës b) të tij.

Në kuadër të zbatimit të nenit 7 të ligjit, kontrolluesi i përpunon të dhënat personale në zbatim të plotë të shkronjës a), c), dhe dh) të pikës 1 të nenit 7.

Gjithashtu, meqenëse të dhënat personale të pacientëve të hedhura në kartelat përkatëse dhe në sistem janë të viteve të fundit, Komisioneri vlerëson se nuk tejkalohen afatet e parashikuara në kreun III “Ruajtja e të dhënave shëndetësore” të Udhëzimit nr. 23, datë 20.11.2012 “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë”. Pra të dhënat personale/sensitive nuk mbahen më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar.

Në kuadër të mbrojtjes së sigurisë së të dhënave personale të pacientëve dhe ruajtjen e konfidencialitetit (neni 27, 28), Komisioneri konstaton se:

- Kontrolluesi disponon një kompjuter të cilin e përdor me qëllim regjistrimin e pacientëve në “*Regjistrin elektronik të pacientëve*”. Ky sistem menaxhohet nga Institucioni ISKSH. ISKSH ka pajisur me “emër përdoruesi” dhe “fjalëkalimin përkatës” një prej punonjësve të autorizuar të kontrolluesit. Nga verifikimi lidhur me aksesin në sistem dhe të drejtat e përdorimit u konstatua se punonjës të tjerë aksesojnë sistemin e ISKSH duke përdorur emrin/fjalëkalimin e punonjësit të autorizuar. Duke qenë në këto kushte, ekziston mundësia e përpunimit/përpunimeve të paautorizuar nëpërmjet shtimit, fshirjes, modifikimit të regjistrimeve në këtë sistem nga personat e paautorizuar apo të pa trajnuar për përdorimin e këtij sistemi.
- Kontrolluesi nuk ka një rregullore të brendshme për sigurinë e të dhënave personale që përpunon.
- Sa i përket sigurisë fizike u konstatua se të gjitha kartelat ndodhen të ekspozuara në dollap pa çelës dhe në ambiente jo të sigurta, çka i bën lehtësisht të aksesueshme nga kushdo. (p.sh. në korridor).
- Personat që kanë akses në kartelat e pacientëve dhe në sistemin e të dhënave, nuk kanë nënshkruar një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale (në zbatimin e nenit 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”).

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. P. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,
 - të hartohet një rregullore e brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale në të cilën të parashikohen masa konkrete sigurie, detyrimet e kontrolluesit dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave. (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë).

Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të merren masa teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave personale, përpunimin e tyre në mënyrë manuale dhe elektronike të tilla si:

- të mundësohen, ambiente të sigurta me akses të kufizuar për dosjet e subjekteve të të dhënave personale, kartelat klinike.
 - të merren masa që punonjësit (përdoruesit) e caktuar në sistemit elektronik për regjistrimin e klientëve të klinikës, të aksesojnë të dhënat në mënyrë të kufizuar vetëm nëpërmjet “emrit të përdoruesit” dhe “fjalëkalimit përkatës të personalizuar”.
2. Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar;
- të përditësohet formulari i njoftimit duke përcaktuar edhe përpunimin e të dhënave sensitive dhe rubrikat e tjera që lidhen me të.
3. Në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar Personat që kanë akses në kartelat e pacientëve dhe në sistemin e të dhënave;
- të nënshkruajnë një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale (në zbatimin e nenit 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”).
4. Këto detyrimeve të rëndësishme që ju ngarkon ligji, të kryhen brenda një afati kohor prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e marrjes dijeni për këtë rekomandim;
5. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
6. Në rast mospërmbyllje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit: “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

